

U D H Ë Z I M
Nr. 47, datë 9.6.2001

**PËR PLOTËSIMIN DHE SHPËRNDARJEN E TABELAVE TË REZULTATEVE NË
QENDRËN E VOTIMIT**

Në mbështetje të nenit 106 dhe 107 të ligjit nr.8609, datë 8.5.2000 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, Komisioni Qendor i Zgjedhjeve

U D H Ë Z O N:

1.Tabelat e rezultateve model 54, 55, 56 plotësohen nga KQV-ja sipas procedurës së përcaktuar në manualin e këtyre komisioneve dhe shënimet udhëzuese në çdo tabelë.

2.Me qëllim shmangien e konfuzionit në KQV dhe zhvillimin e procedurave të sakta dhe të shpejta, rekomadohet që, si rregull, anëtarëve të KQV-së, përfaqësuesve të subjekteve politike ose kandidatëve, si dhe vëzhguesve që dëshirojnë të marrin një kopje të tabelave të rezultateve t’u jepet modeli 56 “Tabela e Përgjithshme e Rezultateve”, tabelë që pasqyron rezultatet e votimit për deputetët e drejtpërdrejtë dhe për deputetët e listës shumëemerore.

3.Në rastet kur një anëtar i KQV-së, përfaqësues i një subjekti zgjedhor ose një vëzhgues, ka kundërshtuar rezultatin e pasqyruar në tabelen model 54 ose 55 dhe për kundërshtimin KQV-ja ka marrë një vendim të cilin ankuesi vazhdon ta kundërshtojë, në këtë rast ose në raste të ngjashme, kërkuesit i jepet një kopje e tabelës së modelit që kërkohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilirian Celibashi